



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

**UDHËZIM**

**Nr. 6, datë 27.01.2015**

**“Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.7 , datë 19.03.2015**

Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 83, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

**UDHËZON:**

**1. Përkufizimi i marrëveshjes kuadër**

Marrëveshja kuadër është një marrëveshje e shkruar midis dy ose me shumë palëve, e cila është rezultat i një procedure prokurimi dhe mbi bazën e së cilës, në mënyrë të përsëritur, realizohet lëvrimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve, në një periudhë të caktuar, sipas kushteve të përcaktuara paraprakisht.

Marrëveshja kuadër nuk përbën një kontratë publike dhe operimi vetëm në bazë të marrëveshjes kuadër, pa lidhur më parë një kontratë të bazuar në të, nuk është e lejuar.

Termat, kushtet dhe standardet e përgjithshme, si dhe kushtet e veçanta të vendosura nga autoritetet kontraktore janë detyruese për marrëveshjen kuadër të lidhur dhe dhënien e kontratave në bazë të saj.

**2. Palët në marrëveshjen kuadër**

**2.1<sup>1</sup>** Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

- a) disa autoriteteve kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë;
- b) disa autoriteteve kontraktore dhe një operatori ekonomik;
- c) një autoriteti kontraktor dhe një operatori ekonomik;
- ç) një autoriteti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë.

<sup>1</sup> Shtuar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015

**2.2** Autoritetet kontraktore që kanë për qëllim të lidhin një marrëveshje kuadër duhet të përcaktohen në njoftimin e procedurës së prokurimit. Në rastin kur procedura e prokurimit, për të lidhur një marrëveshje kuadër, do të zhvillohet nga Organi Qendror Blerës, autoritetet kontraktore që do të jenë palë të marrëveshjes kuadër, duhet të listohen në një aneks, që i bashkangjitet njoftimit të kontratës. Nuk është e lejueshme të përdorin një marrëveshje kuadër autoritetet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër.

**2.3** Të gjithë operatorët ekonomikë, që janë pjesë e marrëveshjes duhet të listohen në marrëveshje dhe nuk është e lejueshme të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë në marrëveshje, pas përfundimit të procesit të prokurimit.

### **3. Qëllimi dhe kushtet për përdorimin e marrëveshjes kuadër**

**3.1** Qëllimi i përdorimit të një marrëveshje kuadër është zhvillimi i procedurave konkurruese të prokurimit, në rastet kur autoritetet kontraktore dinë me siguri objektin e prokurimit, por nuk dinë sasinë, kohën dhe/ose kushte të tjera.

**3.2** Një autoritet kontraktor përzgjedh realizimin e një marrëveshje kuadër, kur në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit:

- a) është e pamundur të përcaktohet objektivisht sasia/sasitë e objektit të prokurimit ose elementëve të tij dhe/ose;
- b) është e pamundur të përcaktohet objektivisht data e saktë e dorëzimit të mallit, punës, shërbimit ose pjesëve të tyre dhe/ose;
- c) është e pamundur të përcaktohet objektivisht vendi i saktë i lëvrimit të mallit, punës, shërbimit, ose pjesëve të tyre dhe/ose;
- ç) është e pamundur të përcaktohen një ose disa kushte të tjera që ndikojnë në realizimin e objektit të prokurimit dhe/ose;
- d) çmimet e tregut janë të paqëndrueshme dhe për arsye teknike dhe teknologjike, objekti i kontratës (malli, puna, shërbimi) mund të dorëzohet nga disa operatorë ekonomikë të suksesshëm, gjë që e bën rihapjen e konkurimit më efektive për shkak të reduktimit të çmimit, sesa fillimin e një procedure të re prokurimi.

### **4. Detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja kuadër**

**4.1** Një marrëveshje kuadër është ligjërish e detyrueshme për të dyja palët. Megjithatë, autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të marrin të gjithë sasinë e mallrave/shërbimeve/punëve, të përfshira në marrëveshje.

**4.2** Në çdo rast, autoritetet kontraktore duhet të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.

**4.3** Gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes.

**4.4** Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.

## **5. Procedurat e prokurimit për lidhjen e një marrëveshje kuadër**

**5.1** Autoriteti kontraktor mund të lidhë një marrëveshje kuadër pas kryerjes së një procedure të hapur, një procedure të kufizuar, një procedure me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, një procedure kërkesë për propozim ose shërbim konsulence.

Në rastin e prokurimit të një marrëveshje kuadër, në kontratat sektorale, autoritetet kontraktore mund të përdorin gjithashtu, procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

**5.2** Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55 të LPP.

**5.3** Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi. Vlerësimi i ofertës/ofertave fituese duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi, bëhet në ato raste kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur objektivisht, të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, si psh. në rastin e medikamenteve, artikujve ushqimor, pjesëve të këmbimit etj.

**5.4** Në rastin kur objekt i marrëveshjes kuadër janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje. Për këtë objekt prokurimi autoriteti kontraktor, mund të përdorë si kriter vlerësimi, çmimin më të ulët, ose ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Në rastin kur si kriter vlerësimi është çmimi më i ulët, renditja përfundimtare e ofertuesve, do të bëhet në bazë të marzhit më të ulët të fitimit, të shprehur në përqindje.

Në rastin kur si kriter vlerësimi do të përdoret oferta ekonomikisht më e favorshme, kriteri i çmimit do të zëvendësohet me marzhin më të ulët të fitimit. Në çdo rast, marzhi i fitimit do të përdoret si kriter vlerësimi vetëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër.

**5.5** Në përfundim të afateve të ankimit, operatorët ekonomikë të kualifikuar në marrëveshjen kuadër renditen sipas kriterit të vlerësimit.

**5.6** Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP dhe rregullat e prokurimit publik.

**5.7** Nëse marrëveshja kuadër do të lidhet me më shumë se një operator ekonomik, autoriteti kontraktor duhet që në njoftim, të përcaktojë ndër të tjera:

- a) kriteret për zgjedhjen e operatorëve ekonomike;
- b) kriteret e vlerësimit që do të përdoren në rihapjen e tenderit për dhënien e kontratës sipas marrëveshjes kuadër.

## **6. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër**

**6.1** Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se katër vjet.

**6.2** Në raste të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme nga subjekti i marrëveshjes kuadër, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër mund të jetë më e gjatë se katër vjet.

## **7. Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër**

**7.1** Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave, që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

**7.2** Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër, duhet t'i referohet për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përlllogaritja e nevojave, duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.

**7.3** Autoriteti kontraktor do të lidhë një marrëveshjeje kuadër nëse ka fonde të mjaftueshme të miratuara në buxhetin vjetor për të mbuluar dhënien e kontratës/ave dhe si rregull çdo vit i vihen në dispozicion fonde për realizimin e punës/mallit/shërbimit sipas marrëveshjes kuadër.

## **8. Llojet e marrëveshjeve kuadër**

**8.1** Marrëveshja kuadër mund të lidhet me:

- a) një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
- b) disa operatorë ekonomikë, ku:
  - të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
  - jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

**8.2** Marrëveshja kuadër me një operator ekonomik mund të lidhet kur për një arsye teknike ose organizative, lëvrimi nga operatorë ekonomikë të ndryshëm nuk është i favorshëm, duke i shkaktuar vështirësi autoritetit kontraktor dhe kosto shtesë (p.sh. mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta, ose në lidhje me përdorimin e tyre sistematik kur ofrohen nga operatorë ekonomikë të ndryshëm).

**8.3** Marrëveshja kuadër me më shumë se një operator ekonomik mund të lidhet kur për shkak të rihapjes së konkurrimit, është e mundur që të ulen çmimet e kontratës ose të shkurtohet periudha e dorëzimit gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër. Autoriteti kontraktor specifikon rregullat për rihapjen e konkurrimit në njoftimin e kontratës për operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër.

**8.4** Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë, nëse të tre operatorët ekonomikë i kanë përmbushur të gjitha kriteret e përzgjedhjes. Në rast të kundërt, autoritetet kontraktore mund të lidhin marrëveshjeje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.

## **9. Marrëveshja kuadër me një operator ekonomik**

**9.1** Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

**9.2** Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik të japë ofertën e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar, ose elektronike (email, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

**9.3<sup>2</sup>** Autoriteti kontraktor dërgon njoftimin e kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik, në Agjencinë e Prokurimit Publik, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

## **10. Marrëveshja kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

**10.1** Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të lidhura me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. <sup>3</sup>Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Kjo lloji marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.

**10.2** Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik, fitues të lotit përkatës, të japë ofertën e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar, ose elektronike (email, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

---

<sup>2</sup> Riformuluar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015.

<sup>3</sup> Fjalja me këtë përmbajtje “*Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës*”, shfuqizuar me Udhëzimin Nr. 7, datë 19.03.2015

**10.3<sup>4</sup>** Autoriteti kontraktor dërgon njoftimin e kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik, në Agjencinë e Prokurimit Publik, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim .

## **11. Marrëveshja kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

**11.1<sup>5</sup>** Në rast të përdorimit të marrëveshjes kuadër me disa operatorë ekonomikë, autoriteti kontraktor për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin.

**11.2** Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik.

Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë:

- a) të dhënat e autoritetit kontraktor;
- b) një përshkrim të plotë të objektit të kontratës;
- c) sasinë;
- ç) afatin dhe vendin për dorëzimin e ofertave;
- d) kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër;
- dh) afatin dhe vendin e realizimit të kontratës;
- e) çdo informacion tjetër të nevojshëm.

**11.3** Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër, ose autoriteti kontraktor mund të përdorë kriteret e tjera me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto kriteret mund të jenë psh. çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulentat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim, ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.

Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat, bëhet në formë të shkruar ose elektronike (e-mail, fax etj) dhe në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës. Në çdo rast, forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.

---

<sup>4</sup> Riformuluar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015.

<sup>5</sup> Riformuluar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015

Autoriteti kontraktor duhet të caktojë kohë të mjaftueshme për dorëzimin e ofertave për çdo kontratë të veçantë, duke pasur parasysh kompleksitetin e objektit të kontratës.

Në çdo rast autoriteti kontraktor duhet t'u dërgojë në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër (psh. në rastin e komunikimit me email, autoriteti kontraktor, duhet ta dërgojë ftesën për ofertë me një email të përbashkët tek të gjithë operatorët ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër).

**11.4**<sup>6</sup> Autoriteti kontraktor dërgon njoftimin e kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik, në Agjencinë e Prokurimit Publik, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

**11.5**<sup>7</sup> Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale.

## **12. Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër**

**12.1** Kontratat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

**12.2**<sup>8</sup> Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurrimit autoriteti kontraktor është i detyruar të krijojë një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër. Përbërja e komisionit nuk është e nevojshme të jetë identike me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

**12.2.1**<sup>9</sup> Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshje kuadër të realizuar nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese. Njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik, do të dërgohet nga autoriteti kontraktor përfitues, në Agjencinë e Prokurimit Publik për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

**12.3** Sasitë e parashikuara janë vetëm “sasi orientuese” dhe nuk e detyrojnë autoritetin kontraktor që të blejë ndonjë prej tyre. Autoriteti kontraktor mundet që të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër). Kontraktuesit nuk do t'i jepet e drejta për kompensim dhe nuk do t'i lejohet që të kërkojë rritjen e çmimit për njësi, si në rastin kur autoriteti kontraktor vendos të blejë sasi më pak ose më shumë se ato të përcaktuara, apo edhe në rastin kur autoriteti kontraktor vendos mos të blejë asnjë nga sasitë e përcaktuara.

<sup>6</sup> Riformuluar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015

<sup>7</sup> Shtuar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015

<sup>8</sup> Riformuluar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015

<sup>9</sup> Shtuar me Udhëzimin Nr.7 datë 19.03.2015

**12.4** Operatori ekonomik që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të formojë një bashkim shoqërisht dhe të paraqesë ofertë për një kontratë, pasi është bërë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

**12.5** Operatori ekonomik që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër që i është dhënë kontrata sipas të njëjtës marrëveshje kuadër.

**12.6** Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë.

Në rast se autoriteti kontraktor konstaton mospërmbushjen e këtij detyrimi, duhet të veprojë konform nenit 47 të Ligjit nr. 9643, datë 20 nëntor 2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar.

### **13. Ndryshimi në numër i palëve të marrëveshjes kuadër**

Nëse para mbarimit të marrëveshjes kuadër të nënshkruar me tre ose më shumë operatorë ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër mbetet vetëm një operator ekonomik, autoriteti kontraktor nuk duhet të japë kontrata sipas kësaj marrëveshje kuadër. Kur lind një situatë e tillë, autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin ekonomik të mbetur në marrëveshjen kuadër. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes kuadër pushon së ekzistuari me këtë njoftim.

### **14. Mundësimi i konkurrencës**

Autoritetet kontraktore nuk duhet të përdorin marrëveshjen kuadër në mënyrë të atillë që të pengojnë, kufizojnë ose të prishin konkurrencën.

**15.** Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 4, datë 08.06.2012, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**